



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.247/8 prot.

Tiranë më 26.04.2023

REKOMANDIM

Nr. 20, datë 26.04.2023

PËR KONTROLLUESIN “MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” (në vijim, “Kontrolluesi ose MFE”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 13 datë, 27.01.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuar nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale për sistemin AFMIS dhe bazave të tjera të të dhënave, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Struktura organizative e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përcaktuar nëpërmjet Urdhrit nr. 89, datë 13.6.2018 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”. MFE ushtron funksionet administrative në bazë të Urdhrit nr. 52, datë 10.3.2021 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të organizimit dhe funksionimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”. MFE kryen veprimtaritë që lidhen me fusha të përgjegjësisë shtetërore të tilla si, politika makroekonomike dhe fiskale, administrimi i të ardhurave

dhe buxhetit të shtetit, menaxhimi i borxhit publik, menaxhimi i financave publike dhe asistencës financiare evropiane e të huaj, etj.

2. Nga verifikimi i kryer rezulton se Kontrolluesi disponon disa sisteme elektronike me të cilat kryen aktivitetin funksional, të tilla si “*Albanian Financial Management Information System*” (në vijim, “*AFMIS*”), etj.;

Baza e të dhënave të sistemit elektronik AFMIS është krijuar sipas VKM nr. 527, datë 25.07.2019 “*Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të menaxhimit financiar*”. Qëllimi i funksionimit të sistemit AFMIS është që t’u shërbejë njësisë shpenzuese, në lidhje me shërbimet që ato kryejnë lidhur me: a) përpilimin dhe regjistrimin e urdhër prokurimeve; b) përpilimin dhe regjistrimin e kontratave; c) përpilimin dhe regjistrimin për pagesë të faturave; d) përpilimin dhe regjistrimin për aprovimin të rishikimeve të buxhetit, përpilimin dhe regjistrimin e ditarëve, etj.

Bazuar në përcaktimet e pikës 5, të nenit 3 të Ligjit, rezulton se MFE gëzon cilësinë e Kontrolluesit sa i përket përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave “*përdorues të sistemit*”. Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen janë: “*emër, mbiemër, numër identifikimi, institucioni, roli, historiku i veprimeve, etj.*”

Referuar specifikimeve teknike të kontratës datë 04.07.2022, lidhur midis palëve, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (në vijim, “*AKSHI*”) dhe bashkimit të operatoreve “*Data Log*” dhe “*Infosoft System*” me objekt: “*Mirëmbajtja e Sistemit Informatik të Menaxhimit Financiar AFMIS – me përfitues Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*”, si dhe verifikimeve në vend, rezulton se AFMIS është i hostuar në dy “*site*”. “*Site*” primar në dhomën e serverëve të MFE dhe “*site*” Sekondar Disaster Recovery (DR), në datacenterin e AKSHI-t.

Sistemi AFMIS është ndërtuar duke u bazuar në teknologjinë e prodhuesit Oracle, konkretisht:

- ✓ Oracle Weblogic Server Enterprise Edition 12c;
- ✓ Oracle Web Center Portal for Oracle Oracle Applications (for electronic documents digital archive);
- ✓ Oracle Database Standard Edition 2 për përdorim të portalit të pagesave të AFMIS. Oracle Database Enterprise Edition 12c;
- ✓ Real Application Clusters One Node 12c;
- ✓ Data Integrator Enterprise Edition for Oracle Applications;
- ✓ Infrastruktura mbështetëse e sistemit konsiston në pajisjet fizike (servera fizike dhe virtuale, storage, pajisje rrjeti) në site primar dhe sekondar, si dhe shërbimet mbështetëse të infrastrukturës si virtualizim dhe cluster-izim.

Bazuar në teknologjinë oracle në të cilën ngrihet sistemi AFMIS janë mbështetur të gjithë komponentët software dhe modulet informatike të tij, si më poshtë vijon:

- ✓ Web portalin e pagesave (AFMIS Web Portal);
- ✓ Medium-Term Budget Planning (MTBP);
- ✓ Public Investment Management (PIM);
- ✓ Buclget Project Portfolio Monitoring (BPPM);
- ✓ Integrimi i sistemit AFMIS me SIFQ;
- ✓ Ndërfaqet e integrit AFMIS me sistemet e tjera (IPSI, APP, EAMIS, HRMIS).

Të dhënat që krijohen nga sistemi AFMIS, ndër të tjera përfshijnë, të dhënat për monitorimin e buxhetit të njësive të qeverisjes qendrore, specifiku:

- ✓ Të dhëna për tavanet buxhetore në nivel njësie të qeverisjes qendrore dhe programi buxhetor;
- ✓ Emërtimet dhe kodet e programeve buxhetore;
- ✓ Të dhënat për projektet e investimeve publike;
- ✓ Të dhënat për produktet, sasi dhe kostot përkatëse;
- ✓ Të dhënat për treguesit e performancës në nivel qëllimi dhe objektiv;
- ✓ Emërtimi dhe kodet e produkteve e të projekteve të investimeve publike;
- ✓ Të dhëna për raporte financiare menaxheriale, monitoruese dhe statistikore.
- ✓ Të dhënat e përdoruesve në rolin e pozicionit të funksionit që ushtrojnë;

Sipas parashikimeve të VKM nr. 527/2019, sistemi AFMIS kryen disa ndërveprime me sisteme dhe platforma elektronike, të tilla si:

- ✓ Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), në administrim të Ministrisë përgjegjëse për financat;
- ✓ Sistemin Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI), në administrim funksional të njësisë përgjegjëse për sistemet e mirëqeverisjes në Kryeministri;
- ✓ Sistemin Informatik të Menaxhimit të Ndhmës së Huaj (SIMNH), në administrim të Ministrisë përgjegjëse për financat;

Ndërkohë, nga konstatimet rezulton se sistemi AFMIS ndërvepron gjithashtu me portalin “*e-Albania*”, për identifikimin dhe krijimin e përdoruesve.

Niveli i aksesit në sistemin dhe në bazën e të dhënave të Sistemit Informatik të Menaxhimit Financiar është si më poshtë vijon:

- ✓ Administratorët e Sistemit Informatik të Menaxhimit Financiar kanë të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi të të dhënave në sistem në lidhje me menaxhimin e përdoruesve, klasifikimin buxhetor e kontabël dhe të subjekteve të regjistruara;
- ✓ Ministritë e linjës kanë të drejtë leximi, shkrimi/modifikimi ose anulimi vetëm për transaksionet që regjistrojnë në sistem;
- ✓ MFE ka të drejta administrative mbi sistemin informatike të menaxhimit financiar me këto role: i) Administrator, ii) Raportues, iii) Auditues, iv) Zhvillues;
- ✓ Punonjës administrativ të autoriteteve shtetërore dhe publike.

Rezulton se, përdoruesit e aksesojnë online sistemin nëpërmjet konfigurimeve të nevojshme duke përdorur një “*browser Web-i*”. Identifikimi i përdoruesve në sistem kryhet përmes llogarisë së krijuar paraprakisht në “*e-Albania*”, në Modulin Qytetar.

Të dhënat që lejojnë një përdorues të hyjë në sistem janë, “NID” dhe “Fjalëkalimi” i llogarisë personale në portalin “e-Albania”.

Përdoruesit administrativ të sistemit mund të logohen sipas modelit “Single Sign-On” (SSO) nëpërmjet llogarisë personale në portalin “e-Albania”. Më pas, përdoruesit mund të aksesojnë ndërfaqen e sistemit AFMIS, sipas nivelit të aksesimit. Konstatohet se të gjithë përdoruesit administrativ të cilët kanë akses në sistemin AFMIS, përdorin të dhënat e llogarive personale të krijuara në Modulin Qytetar, në platformën “e-Albania”, të cilat i kanë krijuar për qëllime të përfitimit të shërbimeve qeveritare në cilësinë e subjektit të të dhënave si “qytetar”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përdorimi i llogarisë individuale në “e-Albania” për qëllime të aksesimit të AFMIS, është në kundërshtim me kërkesat dhe parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit, të cilët përcaktojnë parimet dhe kriteret ligjore për lejimin e një përpunimi të të dhënave.

Në nenin 5 të Ligjit, parashikohet se mbrojtja e të dhënave personale bazohet “[...] në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime” (gërma “b” e pikës 1, të nenit në fjalë).

Sipas nenit 6 të Ligjit, të dhënat personale përpunohen vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;... ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit...; etj.

Ndërveprimi në portalin “e-Albania”, me qëllim identifikimin e përdoruesve të sistemit AFMIS nëpërmjet “Modulit Qytetar”, nuk legjitimohet pasi nuk ekziston as pëlqimi i subjekteve të të dhënave për përdorimin e llogarisë personale për këtë qëllim dhe as një dispozitë ligjore konkrete, që të autorizojë këtë ndërveprim (me Portalin “e-Albania”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në zbatim të detyrimeve që parashikon Ligji, MFE në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale, duhet të marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme t’ju ofrojë përdoruesve të sistemit AFMIS mundësinë e aksesimit të këtij sistemi, pa qenë nevoja e përdorimit të llogarisë personale në “e-Albania” (pra, krejtësisht në cilësinë e punonjësit administrativ të institucionit përkatës).

Marrja e masave të mësipërme nga ana e Kontrolluesit, garanton përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, në përputhje me nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Duhet theksuar që ky proces përpunimi është i vazhdueshëm dhe përfshin një sasi të konsiderueshme të dhënash personale.

3. Kontrolluesi është përfitues i shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit AFMIS, sipas Kontratës nr. 14 prot., datë 04.07.2022, lidhur midis palëve AKSHI dhe bashkimit të

operatoreve “Data Log” dhe “Infosoft Systems” me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit Informatik të Menaxhimit financiar AFMIS – me përfitues Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”. AKSHI është në cilësinë e Autoritetit kontraktues për këtë kontratë, ndërsa “Infosoft Systems” dhe “Data Log” janë operatorët ekonomik që në bashkëpunim, ofrojnë shërbimin sipas objektivit të kontratës.

Nga shqyrtimi në përmbajtje të kontratës së shërbimit, konstatohet se MFE nuk ka marrë masa të përshtatshme sa i përket ushtrimit të kompetencave në cilësinë e Kontrolluesit, mbi caktimin e detyrimeve në kontratën me palët e treta, në kundërshtim me parashikimet e nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave personale dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe rregullohen me aplikimin e Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit.

4. Nga verifikimi në vend i komunikimeve nëpërmjet postës elektronike, si dhe nga shqyrtimi i specifikimeve teknike të sistemit AFMIS, rezulton se komponentët përbërës ku ngrihet infrastruktura e këtij sistemi janë pjesë e aktiveve të MFE. Si rrjedhojë, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe në cilësinë e zotëruesit të pajisjeve, MFE mbart detyrimet që lindin nga ky ligj.

Nga verifikimi i masave organizative dhe teknike të ndërmarra për sistemin AFMIS, rezulton se Kontrolluesi:

- Nuk ka të hartuar planin e politikave të vazhdueshmërisë së biznesit, si dhe një plan për ruajtjen e informacionit, dokumente këto që do të duhet të përmbanin politikat dhe objektivat që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve;
- Nuk ka kryer auditime të brendshme me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të këtyre teknikave për menaxhimin e riskut (ose në mungesë të teknikave, identifikim të riskut);
- Baza e të dhënave të sistemit AFMIS rezulton se nuk është e regjistruar si bazë të dhënash shtetërore në Autoritetin Rregullator Kombëtar për bazat shtetërore (në vijim, “ARK”), referuar ligjit nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” (në vijim, “Ligji nr. 10325”) dhe VKM nr. 945, datë 02.11.2012 Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore” (në vijim, “VKM nr.945”).
- Edhe pse disponon rregulloren nr.1, datë 17.01.2022 “Për sigurinë e Informacionit” të miratuar nga AKSHI, konstatohet se kjo rregullore është e përgjithshme për të gjithë institucionet të cilat kanë të atashuara punonjës të AKSHI-t, por nuk rregullon politikën mbi sigurinë e informacionit, në të cilën të

përfshihet dhe siguria e përpunimit të të dhënave personale, sipas proceseve të punës që kryen Kontrolluesi, ku ndër të tjera të përfshihet edhe sistemi AFMIS.

Gjithashtu, rezulton se MFE nuk ka të miratuar rregullore specifike *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, dhe si rrjedhojë, mungojnë procedurat mbi masat teknike dhe organizative sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një *“Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se nga ana e kontrolluesit duhet të krijohen, zbatohen dhe dokumentohen politika, procedura, rregulla për sigurinë e informacionit, rregullore për mbledhjen, ruajtjen, përpunimin e të dhënave personale, etj., me qëllim uljen e nivelit të riskut të cenimit të sigurisë, në fushën e teknologjisë së informacionit.

Nga ana tjetër, regjistrimi/përditësimi i bazës së të dhënave ku ngrihet sistemi AFMIS pranë ARK-së, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10325/2010 dhe VKM nr. 945/2012, është i nevojshëm për standardizimin dhe sigurimin e saj.

Sa më lart, Kontrolluesi nuk arrin të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*).

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit.

Me shkresën nr. 4832/1, datë 20.03.2023, me lëndë *“Mbi hetimin administrativ të ushtruar nga Zyra e Komisionerit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”*, Kontrolluesi ka paraqitur qëndrimin e tij lidhur me konstatimet e procesverbalit të hetimit administrativ.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit janë paraqitur në seancën dëgjimore datë 24.03.2023, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe kanë shprehur të njëjtat pretendime të paraqitura me shkresën nr. 4832/1, datës 20.03.2023, konkretisht:

Në mënyrë të përmbledhur Kontrolluesi argumenton se: *“Qëllimi i funksionimit të sistemit AFMIS është t'u shërbej njërive shpenzuese në lidhje me shërbimet që ato kryejnë në lidhje me: a) përpilimin dhe regjistrimin e urdhër prokurimeve; b) përpilimin dhe regjistrimin e kontratave; c) përpilimin dhe regjistrimin për pagesë të faturave; d) përpilimin dhe regjistrimin për aprovimin të rishikimeve të buxhetit, përpilimin dhe regjistrimin e ditarëve. “Bazuar në teknologjinë oracle në të cilën ngrihet sistemi AFMIS janë mbështetur të gjithë komponentët software dhe modulet informatike të tij: Web portalin e pagesave (AFMIS Web Portal); Medium-Term Budget Planning (MTBP);”*

Në vijim, Kontrolluesi sqaron se: *“Web Portal nuk shërben për kryerjen e pagesave, por shërben vetëm për dërgimin elektronik të dokumentacionit justifikues të skanuar dhe nënshkruar elektronikisht nga institucioni të transaksioneve buxhetore të NJQP pranë degëve të Thesarit (si psh. urdhër titullari, urdhër prokurimi, kontratë, faturë etj.), si dhe gjurmimin e drejtë për drejtë në WP të fazës së ekzekutimit të transaksionit në SIFQ nga struktura e thesarit..”*

Gjithashtu, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (NJTIK sipas VKM nr. 673) pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shprehet si më poshtë vijon:

“Sistemi AFMIS është një platformë shërbimesh institucionale me natyrë financiare/buxhetore, implementuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të projektit IPS2, dhe i regjistruar si bazë të dhënash shtetërore me VKM nr. 527/2019 sipas ligjit nr. 10325/2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

..Numri i lartë i përdoruesve të sistemit si dhe vetë natyra e ndryshme e shpërndarjes së institucioneve sjell dhe domosdoshmërinë e një menaxhimi të unifikuar dhe të pa-ekuivok të identiteteve (që identifikon përdoruesit) në mënyrë të sigurt, të pavarur dhe të besueshëm. Ky lloj menaxhimi i identitetit të sigurt dhe të besueshëm, është detyrim ligjor që rrjedh nga ligji, nr.107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, si dhe VKM, nr.734, datë 28.08.2013 “Për krijimin e sistemit unik të regjistrimit, autentifikimit dhe identifikimit të përdoruesve në marrjen e shërbimeve publike nga sistemet elektronike” (në vijim, “VKM nr. 734/2013”).

Në këtë kuadër, sistemin AFMIS, që në konceptim, është kërkuar që në zbatim të ligjit dhe standardeve më të mira, të jetë i integruar totalisht (vetëm për qëllim autentifikimi), me sistemin Single Sign-On të AKSHI-t (sanksionuar me VKM nr. 734/2013). Sistemi AFMIS gjithashtu, ka të implementuar Nënshkrimin Elektronik i cili po ashtu është shërbim që

mbështetet krejtësisht në platformën e Nënshkrimit Elektronik RSS (Remote Signing Service) të AKSHI-t, ku çdo përdorues (specialist, nëpunës zbatues, apo nëpunës Autorizues, etj.) duhet të jetë i identifikuar si individ, kërkesë kjo sipas legjislacionit në fuqi për Dokumentet Elektronike dhe Vulën elektronike.

Duam të theksojmë gjithashtu, se profili i përdoruesit AFMIS nuk përmban madje as elementin fjalëkalim, sepse i gjithë procesi i autentifikimit i është besuar platformës SSO të AKSHI-t. Kjo nënkupton se asnjë përdorues administrator i sistemit AFMIS nuk ka akses në fjalëkalime të përdoruesve të sistemit, për vetë arsyen se ato nuk ekzistojnë në AFMIS. Gjithashtu, asnjë përdorues administrator i sistemit AFMIS nuk ka qasje në asnjë informacion apo të dhëna personale të përdoruesit në platformën SSO. Dy sistemet komunikojnë mbi parimin e besimit, të implementuar sipas standardeve TIK për protokollet e federimit, të mundësuar këto nga infrastruktura e vet AKSHI-t...

Pasi sistemi AFMIS merr një konfirmim nga platforma SSO nëpërmjet protokollit të federimit, se përdoruesi ka kryer me sukses autentifikimin e tij (proces i cili është tërësisht i pavarur për AFMIS), merr nga SSO një token të kriptuar ku informacioni që shkëmben sistemin AFMIS me platformën SSO përmban vetëm Numrin Personal dhe orën e autentifikimit të identitetit, verifikon që ky informacion është i vlefshëm dhe i pakompromentuar (për shkak të mekanizmit të federimit) dhe vazhdon me fazën e dytë që është autorizimi..

Autorizimi është procesi i asociimit të identitetit të përdoruesit (të vërtetuar nga SSO), me të drejtat e individit në sistemin AFMIS. Në këtë fazë, identitetit të vërtetuar nga platforma SSO i asociohen rolet dhe të drejtat në sistemin AFMIS. Prosesi i autorizimit ndodh tërësisht në sistemin AFMIS. Prosesi i autorizimit verifikon që personi “X”, identiteti i të cilit është vërtetuar në mënyrë të pavarur nga sistemi SSO është i autorizuar të ketë qasje në resurset e Sistemin AFMIS.

Në konkluzion theksojmë që: Sistemi AFMIS nuk përpunon të dhëna të subjekteve të të dhënave si individ. Sistemi nuk mban apo trajton asnjë të dhënë individuale si mosha, gjinia, statusi civil, vendlindja, apo çfarëdo lloj të dhëne tjetër personale. Sistemi AFMIS gjithashtu nuk ka asnjë lloj qasjeje dhe nuk gjurmon asnjë lloj aktiviteti personal të përdoruesit në platformën “e-Albania”.

Sistemi AFMIS për qëllime vetëm identifikimi, në përputhje të plotë me nenet 2, 5 dhe 6 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mban vetëm minimumin e të dhënave identifikuese të profilit të përdoruesit, Emër Mbiemër dhe Numër Personal dhe për qëllim njoftimi, një adresë e-mail-i (kryesisht zyrtare) të dhënë nga vetë përdoruesi gjatë kërkesës/aplikimit për akses në sistemin AFMIS. Sistemi AFMIS gjithashtu në përputhje të plotë me nenin 5 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, për qëllim të funksionimit të sistemit përpunon informacionin minimal mbi pozicionin e punës dhe institucionin ku përdoruesi kryen funksionin, të dhëna të pranuar në mënyrë shkresore nga MFE tek kërkesa zyrtare për akses.

Në lidhje me pretendimet e mësipërme të Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson ato nuk qëndrojnë duke argumentuar si vijon:

Sipas përkufizimit të nenit 3 të Ligjit:

- ✓ *“E dhënë personale”* është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.
- ✓ *“Përpunim i të dhënave personale”* është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, *“përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale”*, duhet të kryhet në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit në fjalë. Referuar kërkesave të grupit të hetimit administrativ në vend, si dhe zhvillimit të seancës dëgjimore, përfaqësuesit e Kontrolluesit nuk kanë dokumentuar se baza e të dhënave ku ngrihet sistemi AFMIS, rezulton e regjistruar pranë Autoritetit Rregullator Kombëtar. Zyra e Komisionerit vlerëson se, regjistrimi i bazës së të dhënave të këtij sistemi është detyrim ligjor, sipas nenit 12 të ligjit nr. 10325 dhe rregullohet nëpërmjet VKM nr. 945/2012.

Lidhur me pretendimet e paraqitura se ky sistem është i regjistruar, rezulton se Kontrolluesi ka paqartësi mbi detyrimin për regjistrimin e kësaj baze të dhënash pranë ARK, si një detyrim i parashikuar në ligjin nr. 10325/2010 dhe VKM nr. 527/2019, e cila është baza ligjore që ka shërbyer për krijimin e sistemit AFMIS, por jo regjistrimin e tij në ARK.

Sa i përket pretendimit të Kontrolluesit se gjatë autentifikimit të përdoruesve në sistemin AFMIS nuk përdoret ndërveprimi me portalin *“e-Albania”*, por përdoret platforma SSO e AKSHI-t nëpërmjet protokollit të federimit, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk qëndron pasi, mekanizmi teknik *“Single Sign-On (SSO)”*, është skema unike e identifikimit të përdoruesve, duke përdorur një ID dhe fjalëkalim të vetëm në platforma dhe sisteme të ndryshme të e-Qeverisjes, për garantimin e besueshmërisë dhe të sigurisë në ofrimin e shërbimeve elektronike. Ky mekanizëm, u jep mundësi qytetarëve të regjistruar në portalin qeveritar *“e-Albania”*, që nëpërmjet *“Modulit Qytetar”*, të aksesojnë sistemet elektronike me qëllim marrjen e shërbimeve online qeveritare. Pretendimi nga ana e MFE, se VKM nr.734/2013 legjitimon identifikimin e përdoruesve nuk qëndron, pasi kjo VKM përcakton mënyrën e identifikimit të përdoruesve (përfituesve të shërbimeve qeveritare) që do të marrin shërbime qeveritare online përmes një platforme të vetme, por jo autentifikimin e përdoruesve administrativ (punonjës/zyrtarë).

Në lidhje me pretendimet e Kontrolluesit se *“AFMIS nuk përpunon të dhëna të subjekteve të të dhënave si individ...”*, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk qëndron, pasi nga ana tjetër, Kontrolluesi ka detyrimin mbi identifikimin dhe gjurmueshmërinë e veprimeve të përdoruesve të ndryshëm në sistem, si dhe gjurmueshmërinë e funksionaliteteve të vetë sistemit. Vetë sistemi është ngritur teknikisht në mënyrë të tillë që të gjurmojë veprimet e përdoruesve. Gjithashtu, ky pretendim bie në kundërshtim edhe me vetë argumentin e kontrolluesit se: *“Sistemi AFMIS për qëllime vetëm identifikimi, në përputhje të plotë me Nenet 2, 5 dhe 6 të “Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale”, mban vetëm minimumin e të dhënave identifikuese të profilit të përdoruesit, emër, mbiemër dhe numër personal dhe për qëllim njoftimi, një adrese e-mail (kryesisht zyrtare), të dhënë nga vetë përdoruesi gjatë kërkesës/aplikimit për akses në sistemin AFMIS.”*

Të dhënat që përdoren për autentifikim në sistemin AFMIS, janë të dhëna që janë mbledhur me qëllim regjistrimin dhe përdorimin e shërbimeve elektronike qeveritare nga qytetarët nëpërmjet *“Modulit Qytetar”*, në portalin e shërbimeve qeveritare *“e-Albania”*.

Sa i përket ndërveprimit në portalin *“e-Albania”* me qëllim regjistrimin dhe identifikimin e përdoruesve të sistemit AFMIS, sikurse është parashtruar edhe në argumentet më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se ky ndërveprim nuk legjitimohet, pasi nuk ekziston një dispozitë ligjore konkrete, që të autorizojë këtë ndërveprim (me Portalin *“e-Albania”* nëpërmjet mekanizmit teknik SSO), për rrjedhojë, nuk garantohej kriteri ligjor për të legjitimuar përpunimin e të dhënave në rastin konkret.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, ndërveprimi i sistemeve me qëllim shkëmbimin e të dhënave, legjitimohet vetëm nëse përmbushet një prej kritereve të përpunimit, të parashikuara në nenin 6 të Ligjit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuadër të garantimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe garantimit të ligjshmërisë së përpunimit. Plotësimi i detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 20, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa *“a/I”*), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi të marrë masa për përpunimin e të dhënave të përdoruesve gjatë autentifikimit në sistemin AFMIS, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit, duke ofruar një mënyrë që shmang përdorimin e llogarive personale të krijuara për një qëllim tjetër;

2. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
3. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të hartojë “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në përputhje me proceset përpunuese, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
4. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit;
5. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) brenda këtij viti kalendarik, detyrimin e treguar në pikën 1 më sipër;
 - (ii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 2 më sipër;
 - (iii) brenda 45 (dyzet e pesë) ditë, detyrimet e treguara në pikat 3 dhe 4 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

6. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
7. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 26.04.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi